

V E N D I M
date 25.08.2025

I Asamblesë se Përgjithshme të Ortakëve të shoqërisë
“HIGHERPlan” Sh.pk

Në Krujë, sot më datën 25.08.2025 , u mbledh Asambleja e Përgjithshme e ortakëve të shoqërisë
“HIGHERPlan” Sh.p.k, Zj. Rexhina Llubani zotëruese e 100 % të kuotave të kapitalit të
shoqërisë me rend e dite si më poshtë vijon:

Rend Dite:

1. Regjistrimi i Statutit të Shoqërisë **“HIGHERPlan” Sh.pk** pranë Qendrës Kombëtare të
Bisnesit.


Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë, pasi diskutoi me çështjet e përcaktuara në rendin e ditës.

V E N D O S I:

1. Regjistrimi i Statutit të Shoqërisë **“HIGHERPlan” Sh.pk** pranë Qendrës Kombëtare të
Bisnesit.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE TË SHOQËRISË
“HIGHERPlan” Sh.p.k

Rexhina Llubani



STATUTI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“HIGHERPlan” Sh.P.K

Sot më datë 25.08.2025, duke u bazuar në Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, si dhe në Ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit" i ndryshuar, në të nënshkruarit shpreh vullnetin tim të lirë dhe të plotë, për të nënshkruar këtë statut me qëllim krijimin e shoqërisë **“HIGHERPlan” Sh.P.K** - si më poshtë vijon ;

KREU I
Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

NENI 1
Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

- 1.1 Sot, në datë 25.08.2025, une, themeluesja kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **“HIGHERPlan” Sh.P.K**
- 1.2 Themeluesit e shoqërisë janë :
1. **Zj.Rexhina Llubani**, e bija e Enver, e datëlindjes 29.12.1988, lindur në Krujë, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar, e identifikuar me karte identitetit Nr. Personal I86229005M.

E cila ka vendosur krijimin e shoqërisë dhe miratimin e statutit të shoqërisë në bazë të legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë veçanërisht sipas Ligjit 9901 dt 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar dhe si person juridik të zhvillojnë aktivitetin në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi dhe me normat e këtij statuti. Ky statut hyn në fuqi pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

NENI 2
Objekti

- 2.1 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm :
- Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në fushën e trajnimit dhe këshillimit individual apo në grup, online, për zhvillimin personal, profesional dhe të karrierës.
- Objekti përfshin, por nuk kufizohet vetëm në: ofrimin e shërbimeve të këshillimit për stilin e jetesës (life coaching), këshillim për zhvillimin e karrierës (career coaching), këshillim për zhvillimin e biznesit (business coaching), mentorim dhe motivim personal/profesional; organizimin e kurseve, seminareve, workshop-eve, programeve trajnimi dhe edukimi joformal; zhvillimin dhe publikimin e materialeve didaktike, manualeve, librave, botimeve elektronike, aplikacioneve dhe përmbajtjeve audio-vizuale për qëllime trajnimi e zhvillimi.
- Shoqëria mund të ofrojë konsulencë dhe shërbime profesionale lidhur me zhvillimin e aftësive të buta (soft skills), menaxhimin e kohës, komunikimin, lidhësin, menaxhimin e stresit, orientimin dhe planifikimin e karrierës, si edhe integrimin në tregun e punës.
- Gjithashtu, shoqëria ka të drejtë të kryejë aktivitete ndihmëse dhe plotësuese që lidhen me fushën e coaching, mentoring dhe konsulencës, të bashkëpunojë me persona fizikë e juridikë brenda dhe jashtë vendit, të marrë pjesë në projekte kombëtare e ndërkombëtare, si dhe të zhvillojë çdo veprimtari tjetër të lejuar nga ligji që lidhet me fushën e zhvillimit personal, profesional dhe të karrierës..



NENI 3

Kohëzgjatja

- 3.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Bisnesit, me përjashtim të rastit të mbarimit të saj sipas kushteve të parashikuara në ligj ose me vendim të ortakëve të shoqërisë.

NENI 4

Selia

- 4.1 Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: **Rruga “ Nene Tereza” Krujë**

KREU II

NENI 5

Kapitali themeltar

- 5.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 10.000 (dhjetë mijë) Lekë (**sipas ligjit kapitali nuk mund të jetë më i vogël se 100 lekë**). Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
- Ortaku themelues **Zj. Rexhina Llubani**: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 10,000(dhjetë mije) Lekë që përben **100 %** të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 5.2 Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

NENI 6

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

- 6.1 Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit të një eksperti të autorizuar dhe licensuar për keto kontribute me vendim asambleje të shoqërisë sipas kërkesës së administratorit.
- 6.2 Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
- 6.3 Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkojnë për ndryshimin e statutit, vendimet merrën me 2/3 e kuotave pjesëmarrëse
- 6.4 Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

NENI 7

Transferimi i kapitalit

- 7.1 Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashëgimisë;
 - ç) dhurimit;
 - d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.
- 7.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, ndërsa për persona të tjerë jashtë shoqërisë do të funksionojë e drejta e parablerjes, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.
- 7.3 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

NENI 8

Organi Vendimmarres

- 8.1 Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë.
- 8.2 Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

- 8.3 Asambleja e përgjithshme e ortakut është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
 - f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresë se veprimtarisë;
 - g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresë së veprimtarisë;
 - h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 8.4 Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
- 8.5 Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

NENI 9

Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Përgjithshme

- 9.1 Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t’u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- 9.2 Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

NENI 10

Kuorumi

- 10.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
- 10.2 Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “ Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare “, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
- 10.3 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

NENI 11

Marrja e vendimeve

- 11.1 Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 11.2 Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :
- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - ç) përcaktimin e shpërblimeve
 - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresë se veprimtarisë;

e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasyqruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

NENI 12

Përfashtimi nga e drejta e votës

- 12.1 Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
 - ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
- 12.2 Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

NENI 13

Administrimi

- 13.1 Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë.
- 13.2 Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 13.3 Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të Nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
- 13.4 Administrator i shoqërisë do të jenë **Zj. Rexhina Llubani**.

Specimenti i firmës

NENI 14

Kompetencat e Administratorit

- 14.1 Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të veprojë si më poshtë:
- a) kryej të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
 - c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - ç) përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecures së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - d) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarrëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - dh) kryen regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Bisnesit;
 - e) raporton përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - ë) kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- 14.2 Administratori thret Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:
- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- 14.3 Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

NENI 15

Përgjegjësia e Administratorëve

- 15.1 Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

- 15.2 Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorëve dhe ortakëve /ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
- 15.3 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare“, administratori detyrohet:
- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
 - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
 - d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- 15.4 Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- 15.5 Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t’i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t’i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
- 15.6 Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t’i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:
- a) u kthen ortakëve kontributet;
 - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
 - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
 - ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
 - d) jep kredi.

KREU IV **Viti financiar-ekspertet**

NENI 16 **Viti Financiar**

16. Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Qendren Kombetare te Bisnesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

NENI 17

Ekspertet

- 17.1 Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gje të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.
- 17.2 Në përfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar për gatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat

është i detyruar që t'ja paraqese e dorezoje në kohe ortakeve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Kreu V
Prishja –riorganizimi i shoqërisë

NENI 18

Prishja dhe likuidimi

- 18.1 Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet në cdo kohe :
- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
 - b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
 - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
 - ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
 - d) me vendim të gjykatës;
- 18.2 Në këtë rast Ortaket marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtesë “ Shoqëri në likuidim e sipër “.
- 18.3 Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pague, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.
- 18.4 Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket me vendim asambleje
- 18.5 Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

NENI 19

Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja

- 19.1 Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

NENI 20

Baza Ligjore

- 20.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislationit shqiptar.
- 20.2 Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

NENI 21

Mosmarrëveshjet

- 21.1 Për mosmarreveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarreveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

ORTAKËT
I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
REXHINA LLUBANI

Rexhina Llubani

